
A PEACEFUL SETTLEMENT OF DISPUTES: A CROATIAN-SLOVENIAN DISPUTE OVER THE DEMARCATION OF THE SEA BORDER

Arijeta Selimi

Southeast European University, Tetovo, a_selimi77@hotmail.com

Abstract: This paper analyzes a conflict that was once allegedly solved, but it was found that unjust means were used when reaching the arbitration agreement.

Arbitration in the Slovenian-Croatian dispute contributed positively to Croatia's accession to the European Union (EU), but the resolution of the main problem (the definitive establishment of the borderline) remains open as an unresolved issue. While Croatia became an EU member state with an interim agreement, which was later challenged as a result of abuse of the position of an arbiter in the process and a diplomat from the Slovenian Foreign Ministry.

The main goal is to analyze the essence of the problem, the development of the events through the stages of Croatia's membership negotiations in the EU.

Also, in the context of the work, interviews with prominent figures from the academic faculty and politicians of the two countries will be conducted, where they will be assessed for the entire process. In the end, conclusions and recommendations for further research and possible definitive dispute resolution will be drawn.

Keywords: Croatia, European Union, international arbitration.

ZGJIDHJA PAQËSORE E KONTESTEVE: KONTESTI KROATO - SLOVENI MBI DEMARKACIONIN E KUFIRIT DETAR

Arijeta Selimi

Southeast European University, Tetovo, a_selimi77@hotmail.com

Ky punim analizon një konflikt i cili duket se ishte i zgjidhur, mirëpo u tregua se gjate arritjes së marrveshjes së arbitrazhit ishin përdorur mjete jolegale.

Arbitrazhi në kontestin slloveno – kroat ndikoi pozitivisht ndaj qasjes së Kroacisë në Bashkimin Evropian, por zgjidhja e problemit kryesorë (përcaktimi definitiv i vijës kufitare detare) mbetet i hapur dhe çështje e pazgjidhur. Përderisa Kroacia u bë anëtare e Bashkimit Evropian me arritjen e një marrveshjeje të përkohshme, e cila më vonë u kontestua si rezultat i keqpërdorimit të pozitës të njërit arbitër në proces dhe diplomat i ministrisë së punëve të jashtme sllovene.

Qëllimi kryesorë është që të analizohet thelbi i problemit, zhvillimi i ngjarjeve nëpër etapa e deri në kushtëzimin përmes negociatave për antarësimin e Kroacisë në BE.

Poashtu, në kornizat e këtij punimi do të zbatohen intervista me personalitete të shquara të botës akademike dhe politikan të dyja shteteve nga janë nxjerrur vlerësime për tërë procesin. Në fund do të nxjerren përfundime dhe rekomandime për hulumtime të mëtejshme dhe për zgjidhje të mundshme dhe definitiv të kontestit.

Fjalë kyqe: Kroaci, Bashkimi Evropian, arbitrazhi ndërkombëtarë.

1. HYRJE

Nëse do të zbatonim kriteriumet e *Lacoste*²¹³, që sipas të cilave një rivalitet mund të përcaktohet si gjeopolitik, atehere mund të konstatohet se kontesti Slloveno – Kroat është shembull i rivalitetit gjeopolitik bashkëkohore, por jo edhe konflikt.

Mund të theksohet që ky kontest nuk e ka qëllimin tek territori shtetëror, në kuptimin më të ngushtë të fjalës, por që ka për qëllim ujërat territorial. Duhet të theksohet që ujërat territorial konsiderohen të jenë pjesë e territorit shtetëror, por gjithsesi që nuk bëhet fjalë për pjesën tokësore të territorit, por që bëhet fjalë për pjesën ujore. Ajo pjesë detare, që është arsyeja e kontestit mes Kroacisë dhe Sllovenisë, nuk ka marr formën e kontestit shkaku i vlerave të saja në kuptimin e shfrytëzimit ekonomik, por ajo pjesë detare paraqet një pjesë më se të rëndësishme, gjëgjësisht të domosdoshme të detit për shkak se Sllovenia ka hendikep gjeografik si shtet dhe i shërben për të lidhur detin territorial slloven me detin e hapur në Adriatik.

²¹³ Lacoste, Y., 2000.: Rivalries for Territory, *Journal of Geopolitics*, vol. 5, nr. 2, fq. 120-158

2. KONTEKSTI TEORIK I PROBLEMIT

Shpejte pas pavarësimit të Sllovenisë dhe Kroacisë, mes tyre u realizuan më shumë takime në nivel të grupeve punonjëse ekspertësh, në kuadër të delegacioneve qeveritare ku u arritën bazat për bashkëpunim mes dy shteteve dhe zgjidhjen e problemeve të hapura në lidhje me çështjet kufitare. Kroacia, prej 1991, parimisht ka qene e preokupuar me okupimin serb dhe luftën me okupatorin serb, shkaku i te cilit çështjeve të hapura me Slloveninë nuk u ka dhënë shumë rëndësi, sepse mbrojtja nga armiku dhe cilrimi i zonave përkohësisht të okupuara ishin çështje e mbijetesës së shtetit kroat, ndërsa pjesërisht arsye tjetër ishte se, Kroacia dhe Sllovenia tradicionalisht kishin pasur raporte të mira.²¹⁴

Qe nga pavarësimi i Sllovenisë nga RSFJ-ja, më thjeshtë thënë, interesi më i madh slloven ka qene mbrojtja e pronës së madhe sllovene në Kroaci, derisa interesi me i madh kroat ka qene, kalimi sa me i lehtë përmes Sllovenisë në Evropë. Ne lidhje me këtë, u nënshkruan dy marrveshje, Marrveshja per komunikacion kufitarë dhe bashkëpunim 1997 (të cilin Sllovenia e ratifikoi me 2001.) dhe marrveshja per rregullimin e çështjeve pronësore të vitit 1999. Gjatë tërë kohës qe nuk kishin pasur sukses negociatat mes këtyre dy shteteve, kishin ndodhur incidente ne gjirin e Piranëve, mosmarrveshje dhe moskujdes në zgjidhjen e kontestit si dhe deklarata te pamatura te politikanëve slloven te cilat dhe më shumë kishin potencuar konfliktet.

Rrypi i mbrojtur ekologjik i peshkimit (Zašticeni ekološki-ribolovni pojas, ZERP) u shpall, me vendimin e parlamentit Kroat me 3. tetor te vitit 2003. Sipas vendimit te kuvendit, regjimi ligjor i rrypit te mbrojtur ekologjik te peshkimit (ZERP) te Kroacise, ka filluar te zbatohet me 3. tetorë 2004. I cili fillimisht nuk ishte zbatuar mbi anijet te cilat lundronin nën flamurin e shteteve anëtare te BE.

Kuvendi republikan i Republikës së Kroacise, më 15 dhjetor 2006, ka ndryshuar vendimin e mëparshem duke filluar zbatimin e regjimit ligjorë të ZERP-it për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, me 1 janar të vitit 2008. Duke pranuar raportin e qeverisë së Republikës së Kroacise, dhe duke vërtetuar se interesi strategjik i Kroacise është anëtarësimi në BE, parlamenti kroat me datën 13 mars të 2008 solli vendimin me të cilin ZERP-i përkohësisht nuk do të zbatohet mbi shtetet anëtare te BE-së, nga 15 mars i vitit 2008, deri sa nuk do të gjendet një marrveshje e përbashkët në frymën evropiane dhe të bashkëpunimit.

Si kundërpërgjigje e ZERP-it kroat, Parlamenti slloven, me datën 4 tetorë të 2005, shpalli zonën ekologjike sllovene dhe rrypin epikontinental i cili shtrihet në ujrat territoriale kroate dhe në zonën e ZERP-it kroat. Me fuqizimin e ligjit kroat për ZERP-in, më 1. janar të 2008, Sllovenia shfrytëzoi të kryesuarit e saj me BE, për të bllokuar negociatat e antarsimit të Kroacisë në BE, që kushtëzoi Kroacinë të heq dorë nga zbatimi i ZERP-it , më 13. mars, pas së cilës u deblokua procesi negocijues. Sllovenia filloi përsëri me bllokadën e negociatave të Kroacisë në tetorë të 2008, me arsyetim se Kroacia me dokumentat që ia kishte dorëzuar organeve të BE-së, në kuadër të procesit të antarësimit, prejjudikon kufirin e përbashkët, në tokë dhe në det. Fillimisht, në konferencën e pranimit, më 30. tetorë 2008, ka bllokuar hapjen e katër kapitujve dhe mbylljen e një kapitulli dhe më pas në konferencën e rradhës të 19. dhjetorit të 2008, numri i kapitujve të bllokuara u rrit në dhjetë. Gjatë kryesimit çek, në gjysmën e parë të vitit. 2009, kur për herë të parë prej kur ishin hapur negociatat, nuk u mbajt asnjë konferencë, numri i kapitujve të bllokuara të gatshme për hapje, u rrit në 9 kapituj, kurse për mbyllje u rrit në pesë.

Kryeministria kroate, Jadranka Kosor dhe kryeministri slloven, Borut Pahor, më 11. shtator të 2009, bien dakord për zhbllokimin e negociatave për anëtarësimin e Kroacisë në BE si dhe për zgjidhjen e kontestit kufitar para gjykatës së arbitrazhit. Parlamenti kroat më 2. nëntorë të 2009, i jep qeverisë miratimin për nënshkrim, ashtuqë më 4. nëntorë të 2009, Kroacia dhe Sllovenia nënshkruan marrveshjen e Arbitrazhit në Stockholm , të cilin Parlamenti kroat e ratifikoi më 20. nëntorë të 2009.²¹⁵ Më 6 qershorë të 2010, me përkrahjen e referendumit për marrveshjen e Arbitrazhit, Sllovenia zhbllokoi negociatat për anëtarësimin e Kroacisë në BE, me të cilën u hapën tre kapitujt negocijuese të cilat kishin ngelur. Më 13. qershorë të 2011, në Bruxelles, në takimin e trembëdhjetë të konferencës ndërqeveritare rreth pranimit të Kroacisë në BE, në nivel ministror, Kroacia mbylli negociatat në katër kapitujve të fundit. Me këtë u mbyllën të gjitha 35 kapitujt dhe zyrtarisht u përfundua procesi i anëtarësimit të Kroacisë në BE²¹⁶.

Mardhëniet kroato – sllovene në periudhën e fundit ishin konkurrese kur superioriteti ekonomik slloven dhe investimet e qëllimshme në infrastrukturë, u mundësuan banorëve të zonave kufitare të Istrës, të lidhen egzistenacialisht për Slloveninë. Duke krijuar zona kontestuese në formë të veprimt të sinkronizuar,

²¹⁴ Tomaić, T & Altić, M, „Hrvatsko – Slovenska granica na rijeci Dragonji”, Matica hrvatska – Ogranak u Rijeci, Rijeka 2013, fq. 87

²¹⁵ Për më tepër shih në: Tomaić.T,(2011). *Kriza medjunarodnih odnosa – studija slučaja: granica u Istri*, ČSP, br.2, fq. 402-403

²¹⁶ Po aty

Sllovenia, potencimin e problemit me eksploatim medial e ngriti në nivel diplomatik, duke forcuar tensionet politike si dhe duke shprehur pretendime²¹⁷. Rol të veçantë në procesin e forcimit të pozitës negocijuese sllovene, ndaj Kroacisë, kanë pasur dhe institucionet e inteligjencës sllovene që kanë përdorur situatën e paqëndrueshme politike në Kroaci në vitet e '90-ta. Kroacia gjatë luftës me Sërbinë ka mbrojtur kufijtë lindore dhe jugore të saja, të cilën Sllovenia në formë diplomatike dhe politike i kishte shfrytëzuar shkakun se asaj kohe vëmendja e tërë shtetit të Kroacisë ishte përqëndruar në konfliktin e armatosur me armatën e Jugosllavisë dhe njësisive paraushtarake serbe.

Përpyekjet e meparshme të dështuara rreth zgjidhjes së kontestit kufitarë mes Kroacisë dhe Sllovenisë ishin marrveshja, Drnovšek– Račan të 20. korrikut, 2001., takimi i qeverisë në Brijuni më 10. qershorë të 2005, si dhe marrveshja e kryeministrit kroat Ivo Sanader dhe atij Slloven Janez Janše, në Bled, në 26. gusht të 2007.

2.1 DEFINIMI I KËRKESAVE TË DY SHTETEVE

- Kërkesat e Sllovenisë rreth demarkacionit

Edhe pse Sllovenia në marrveshjen e saj të parë për kufirin e përbashkët, të vitit 1991, propozoi që kufiri në gjirin e Piranëve shkoi me vijën e mesit, vitin e ardhshëm ajo ndryshoi qëndrimin e saj rreth kufirit detar mes dy shteteve. Ministri slloven i punëve të jashtme, më 5. qershorë 1992. doli me qëndrimin e sorvanitetit të Sllovenisë mbi gjithë gjirin e Piranëve.²¹⁸ Prej atëherë e deri në momentin e marrveshjes së Arbitrazhit, politika zyrtare e Sllovenisë, përfaqësoi qëndrimin e saj me atë që e kishte plotësuar me kërkesën me të cilën kërkonte dalje territoriale deri në detin e hapur. Mund të thuhet se qëndrimet e Sllovenisë rreth kufirit në det më qartë janë të definuara në memorandumun për gjirin e Piranëve të 7. prillit 1993. të cilin parlamenti slloven e miratoi.

-Kërkesat e Kroacisë rreth demarkacionit

Kroacia, pikpamjet e saja rreth çështjes së demarkacionit me Slloveninë, i ka shprehur në tre paragrafet e deklaratës mbi gjendjen e mardhënieve ndërshtetërore të Kroacisë dhe Sllovenisë.²¹⁹

Deklarata ka të njëjtin kuptim si të memorandumit slloven, pasi që ajo është miratuar nga organi më i lartë legjislativ të Republikës së Kroacisë dhe dhomës së përfaqësuesve të parlamentit kroat.

Analiza ligjore ndërkombëtare, e përmbajtjes së deklaratës na zbulon katër cilësimet e mëposhtme themelore të Kroacisë, të lidhura me demarkacionin me Slloveninë: a) Marrveshja për komunikacion kufitarë dhe bashkëpunim është një kornizë e mirë për të realizuar interesat e popullsisë në zonën kufitare; b) Ekuidistanca është metodë e cila duhet të zbatohet për caktimin e kufijve – demarkacion; c) Për një zgjidhje të përkohshme, linja e mesit është poashtu valide dhe d) Zgjidhja e mosmarrveshjeve duhet të kryhet me mjete ligjore.²²⁰

Republika e Kroacisë në mirëbesim ka pranuar marrveshjen e Arbitrazhit dhe ishte e gatshme që para *ad hoc* Gjykatës së Arbitrazhit të zgjidh kontestin kufitarë me Slloveninë dhe atë në mënyrë dhe me kushtet siç ishin përcaktuar në marrveshjen e Arbitrazhit. Ndër të tjera në marrveshjen e Arbitrazhit ishte definuar se procesi do të zhvillohej në përputhje me rregullat e gjykatës së përhershme të Arbitrazhit e cila shprehimisht theksoi paanshmërinë dhe pavarësinë e arbitrave, si virtyte themelore të gjygtarëve të cilët vendosin në procedurën e arbitrazhit, gjersa palëve në procedurë qartë u ishte ndaluar ndërmarrja e aktivitete që do të kishin mundur të rrezikojnë punën e gjykatës së Arbitrazhit.

Pasi që publikisht kishin dalur deklaratat të ministrit të punëve të jashtme të Sllovenisë, me sygjerime se janë në dije me rezultatet e mundshme të procesit të arbitrazhit dhe se Sllovenia ka kanalën e saj të komunikimit me Gjykatën e Arbitrazhit, ministrja e punëve evropiane dhe të jashtme të Kroacisë Vesna Pusić iu drejtua Gjykatës së Arbitrazhit duke kërkuar shpjegim, përderisa gjykata e Arbitrazhit vërtetonte se ruajtja e besueshmërisë së arbitrazhit është prioritare dhe se Sllovenia nuk ka pasur asnjë informatë lidhur me rezultatet eventuale të gjykatës.

Në qershorë të 2017 gjykata e Arbitrazhit solli vendimin ku në gjykatë nuk morën pjesë përfaqësuesit e Kroacisë, ku pjesa më e madhe e gjirit të Piranëve vendoset tu jepet Sllovenëve por që Kroacia këtë vendim nuk e pranon si të qëndrueshëm ngaqë Parlamenti kroat në një seancë të jashtëzakonshme të vitit 2015 pasi që procesi u kontaminua, njëzëri solli vendimin me të cilin detyron Qeverinë e Republikës së Kroacisë, për fillimin

²¹⁷ N. ŠETIĆ, “Istarski razgovori”, Zagreb 2003, fq. 55

²¹⁸ Despot, Z., Cvek, M., artikull në “Vecernji List” me titull «Geodet Seissel ima tajne adute za međunarodnu arbitražu oko Piranskog zaljeva», 17. qershorë 2000., fq. 44.-45.

²¹⁹ Deklaracija o stanju međudržavnih odnosa Republike Hrvatske i Republike Slovenije, NN broj 32/99,

e datës 2 prill 1999., fq. 1089-1090.

²²⁰ Tutkalj, K., *Piranski Zaljev, Razgranicenje teritorialnog mora između Hrvatske i Slovenije*, Organizator, Zagreb 2001. Vep. e cit, Fq. 25

e procedurës për nderprerjen e marrveshjes së arbitrazhit mes Kroacisë dhe Sllovenisë, shkaku i shkeljes esenciale të marrveshjes nga ana e Sllovenisë.

3. ANALIZA E INTERVISTËS

Intervistën e kam realizuar me disa figura eminente të botës akademike dhe politike kroate dhe sllovene.

- Intervista me prof. dr. sc. Ivo Josipović (Kroaci) ish-Kryetari i Republikës së Kroacisë (periudha 2010-2015).

Është e rëndësishme ta theksoj se **prof. dr. Ivo Josipović** ka qenë në funksionin e kryetarit të Kroacisë gjatë periudhës kur është nënshkruar marrëveshja e Arbitrazhit mes Kroacisë dhe Sllovenisë dhe profesor ordinar në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Zagrebit.

- Prof. Ivo Josipovic konsideron se Sllovenia i ka thyer rregullat e Arbitrazhit në një mënyrë shumë drastike dhe me këtë ka “kontaminuar” Arbitrazhin në mënyrë të papërmirësueshme. Komunikimi i palejueshëm ndaj arbitrave, përpjekjet për t’i ndikuar ata si dhe lëndimi i rregullave të tjera të veprimit kanë shkuar aq larg sa që asnjëri që është objektiv nuk beson që Arbitrazhi mund objektivisht dhe me drejtësi ta sjellë procesin deri në fund. Më tutje thot se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është gjykata më e mirë, kompetente dhe me autoritet të madh ligjor, moral dhe politik dhe çështja e kufirit do të duhej të zgjidhej para asaj Gjykate. Thotë se në Kroaci kanë qenë të dëshpëruar nga tentimi i Sllovenisë që edhe pas përparësisë që kishte me imponimin e marrëveshjes së Arbitrazhit, me masa joligjore dhe jomorale kishin vazhduar të tentojnë të ndikojnë në rezultatet e kontestit. Nga ana tjetër, kjo ishte arsye për t’u tërhequr nga Arbitrazhi të cilën e kanë konsideruar të padrejtë. Më tutje shton që të dyja shtetet janë jashtëzakonisht të lidhura, politikisht, ekonomikisht dhe në aspekt njerëzor, që është arsye që e tërë kjo aferë ka rënë në plan të dytë relativisht shpejt.

- Intervista me Prof. Dr. Bojko Bučar (Slloveni) profesor në katedrën e mardhënieve ndërkombëtare pranë fakultetit të shkencave sociale në Univerzitetin e Ljubljanes.

Prof. Bucar konsideron se duhet patur parasyshë se të dyja shtetet njëzet vjet janë përpjekur të zgjedhin kontestin me negocijata, me koncilijim (pajtim), është kundërshtuar ideja e Gjykatës detare të Hamburgut dhe Gjykata ndërshtetërore në Haag. Në fund, dy shtetet me ndihmën e ndërmjetësimit të BE-së, kanë ardhur deri te zgjidhja e problemit mes Arbitrazhit. Dhe atë vetëm sepse ishte mënyra e vetme e largimit të vetos nga ana e Sllovenisë për hyrjen e Kroacisë në BE.

Ai shton se Sllovenia ka refuzuar që kontestin ta zgjidh ne kuadër të gjykatës së Kombeve të Bashkuara, por thekson se nëse Kroacia refuzon vendimin e Arbitrazhit atëherë Sllovenia do te detyrohet që ta kalojë kontestin rreth pranimit të vendimit të Arbitrazhit në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës.

4. PËRFUNDIM

Mund të arrihet ne konkludim se nëse çështja e kufirit detar do të depolitizohet në tërësi dhe do të reduktohet kryesisht vetëm në zbatimin e rregullave ligjore të rastit konkret, çështja e përkufizimit do të mund të zgjidhet me shumë lehtësi. Zgjidhja e këtij problemi qëndron në zbatimin e rregullave pozitive ligjore të së drejtës ndërkombëtare, gjegjësisht në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj të cilave të dyja shtetet janë palë dhe obligohen që t’i respektojnë vendimet. Rregullat e ligjit ndërkombëtar, vendimi i organeve ndërkombëtare dhe praktika e deritanishme e vendeve gjatë marrëveshjeve rreth kufijve në det, përmbajnë përgjigje për shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë me demarkacionin në det. Për demarkacion mes Sllovenisë dhe Kroacisë më se relevante konsiderohen dispozitat e nenit 2 dhe 15 e Konventës për të Drejtën Detare. Me zbatimin e tyre, arrihet deri tek përgjigjet e qarta rreth pyetjeve se si tërhiqen kufijtë e detit territorial.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Deklaracija o stanju međudržavnih odnosa Republike Hrvatske i Republike Slovenije, NN broj 32/99, e datës 2 prill 1999
- [2] Despot, Z., Cvek, M., artikull në “Vecernji List” me titull «Geodet Seissel ima tajne adute za međunarodnu arbitražu oko Piranskog zaljeva», 17. qërshorë 2000
- [3] Lacoste, Y., 2000.: Rivalries for Territory, *Journal of Geopolitics*, vol. 5, nr. 2
- [4] N. ŠETIĆ, “Istarski razgovori”, Zagreb 2003
- [5] Simoniti, I., Sotlar, M., “The Land Boundary Between the Republic of Slovenia and Republic of Croatia and the Negotiations on the Maritime Boundary delimitation”, JIR, 1996
- [6] Tomaić, T & Altić, M., „Hrvatsko – Slovenska granica na rijeci Dragonji”, Matica hrvatska – Ogranak u Rijeci, Rijeka 2013
- [7] Tomaić, T., (2011). *Kriza međunarodnih odnosa – studija slučaja: granica u Istri*, ČSP, br.2
- [8] Tutkalj, K, *Piranski Zaljev, Razgranicenje teritorialnog mora između Hrvatske i Slovenije*, Organizator, Zagreb 2001

ⁱP. Bourdieu, Per un corporativismo dell'universale, në Le regole dell'arte: genesi e struttura del campo letterario, Il Saggiatore, Milano 2005, fq. 425-437.

ⁱⁱF. De Sanctis, *Storia della letteratura italiana*, Bari Gius. Laterza & Figli, Tipografi-Editori-Libraii, 1912.

ⁱⁱⁱE. Auerbach, Filologia della Weltliteratur, in San Francesco Dante Vico ed altri saggi di filologia romanza, De Donato, Bari 1970, fq. 191.

^{iv}F. Fortini, Intellettuali, ruolo e funzione, in Questioni di frontiera. Scritti di politica e di letteratura 1965-1977, Einaudi, Torino 1977, fq. 68-73.

^v*Affaire Dreyfus*, rasti i bujshëm i dënimit të kapitenit Alfred Dreyfus në Francë, me origjinë hebraike, i cili iu nënshtrua një procesi gjyqësor që zgjati nga 1894-1906, dhe tronditi shoqërinë franceze. Shkrimtari i famshëm frances Emil Zola denoncoi skandalin në gazetën e përditshme *Aurore* me sditorialin *J'accuse*, që shkaktoi një varg krizash të paprecedenta në Francë e më pas edhe në rajon.

^{vi}L. Sciascia, *L'affaire Moro. Con aggiunta la relazione parlamentare*, Adelphi, 1994.

^{vii}E. W. Said, Dire la verità. Gli intellettuali e il potere, Feltrinelli, Milano 1995, pp. 9-27.

^{viii}C. Bordoni, Società digitali. Mutamenti culturali e nuovi media, Liguori, Napoli 2007, pp. 141-142.

^{ix}A. Plasari, "Letërsia dhe muret, në "Bota Letrare i/1991, revistë tremujore për letrërsinë e huaj, botim i lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, fq.177-207.